



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 203, Datë 13.09.2018

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS NR. 73 SERIA FK08, TË SHOQËRISË “GEN-I TIRANA”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1 gërma “d”, neneve 13 dhe 16 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 13.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për rinovimin e licencës nr. 73 Seria FK08, të shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k, në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 73 Seria FK08, për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike dhënë me venimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 129, datë 02.12.2008, për një afat 5 – vjeçar.
- Kjo licencë është rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me nr. 104, datë 01.10.2013, për një afat 5 vjeçar.
- Në prag të përfundimit të afatit kohor të licencës, shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., kërkon rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike në bazë të nenit 16, pika 1 (*Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës duke paraqitur dokumentat përkatëse*) të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.

- Bordi i ERE me vendimin nr. 185, datë 20.08.2018, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k., në vepritarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të sa më sipër, ERE me shkresën nr. 55/55 Prot., datë 23.08.2018, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 523/1 Prot., datë 23.08.2018, i ka kërkuar subjektit “Gen-I Tirana” sh.p.k., të paraqesë në ERE dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me bilancin financiar të vitit 2017, duke qënë se nga analiza e dokumentacionit të aplikimit, rezultoi se nuk ishte paraqitur.
- Subjektit “Gen-I Tirana” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 523/2 Prot., datë 29.08.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar sipërcituar.
- Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Gen – I Tirana” sh.p.k., gjatë fazës finale të shqyrtimit në bazë të “*Rregullores për Procedurat e Licencimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licensave*”, rezulton si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1. Plotësuar;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2. Plotësuar;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3. Plotësuar;
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pikat 4.7 dhe 4.7.1. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 73 Seria FK08, të shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k., në vepritarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI